

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 6 TETOR 2022

Në fakt, kisha programuar të flisja për diçka krejt tjetër, sepse sot shqetësim madhor është çështja e sigurisë kombëtare, ku siguria kibernetike përbën një nga shtyllat jetësore të mbijetesës së një shteti normal në demokraci, por, para se të kaloj tek ajo pikë, do të doja të flisja në lidhje me një gënjeshtër të madhe, që ministrja Spiropali ua serviri shqiptarëve pa iu dridhur qerpiku. E dëgjua se çfarë tha?! Radhën e kaluar, kur ishte momenti për të folur për zonën e saj, u largua dhe nuk dëgjoi. Tani, sapo pa që unë po insistoja për të folur, iku përsëri. Pse? Sepse nuk mund ta pranojë të vërtetën. Tha që qeveria e “Rilindjes” i ka bërë Kamzës mrekuillinë!

Ne të opozitës qenkemi qorra, as kemi parë dhe as ditkemi gjë! Por më e rënda është se edhe banorët e asaj zone as shohin dhe as ndiejnë gjë, përveç varfërisë, shpopullimit, rrënimit dhe shkatërrimit në çdo aspekt. Vetëm Elisa është në botën e çudirave dhe, nga kjo botë me shkop magjik mendon se mund t’ua servirë shqiptarëve dhe banorëve të zonës së saj virtualen e botës së çudirave, si një gjë reale. Kjo është Elisa! Është meritë e “Skënderbeut”, që e gradon, e nominon, e promovon vetëm për një gjë: fresk, fresk, fresk, pa iu dridhur qerpiku për të gënjer dhe për të mashtruar. Por këtu është ministre dhe, si ministre, ka përgjegjësi të tjera, të paktën përballë elektoratit të saj dhe përgjithësisht ndaj qytetarëve shqiptarë. “Kemi ndërtuar shkolla, kopshte, çerdhe”, tha.

A mund të japë përgjigje zonja ministre ku është shkolla që është ndërtuar? Le të thotë një shkollë të ndërtuar në të gjithë zonën e saj elektorale; le të thotë një kopsht të ndërtuar; le të thotë një shtëpi që kanë marrë të dëmtuarit nga tërmeti në Kamzë! Po ju them një gjë: Sefije Myrto, banore e Kamzës, shtëpia e së cilës është rrënuar nga tërmeti në nivelin DS5, ka 3 vjet që me të gjithë familjen dhe fëmijët fle natën në plastmasë. Ditën shkon te dera e bashkisë, sepse shtëpia që i takon asaj është shitur dhe shtëpitë që u takojnë të tjerëve u janë dhënë

patronazhistëve në Valias. E përmendi me emër. Le të vijë zonja ministre, ta thotë këtu! Dhe çfarë merr ajo nga bashkia?

Gjithsecili prej nesh këtu fle nëpër shtëpi, krevate, dyshekë, zonja fle pak më mirë se ne të tjerët, që të jemi të qartë... Po, Pandi, po, ka luks zonja, ndaj thashë se është më mirë se ne të tjerët, ndërsa banorët dhe Sefije Myrto flenë në plastmasë. Fëmijët tanë flenë nëpër shtëpi, fëmijët e Sefijes që prej 3 vjetësh flenë në plastmasë, ku hyn uji dhe i ftohti; nuk kanë as për të ngrënë, kujtohen komshinjtë për t'u dhënë ushqim. Zonja kapardiset dhe gënjen këtu! Ajo shkon te bashkia dhe kryetari i Elisës i nxjerr Policinë Bashkiake, për ta rrahur edhe Sefijen si nënë, por edhe fëmijët, për t'i përzënë ata, në vend të nxjerrë një vendim dhe t'ua japë shtëpinë që ua ka prishur tërmeti. Por çfarë ka ndodhur?

Eja, moj Elisa, të shkojmë bashkë në Valias dhe shikoj ato dy pallatet që keni ndërtuar ju! A ka marrë shtëpi aty ndonjë banor që i është dëmtuar shtëpia nga tërmeti? Jo, kanë marrë vetëm patronazhistët, militantët dhe një pjesë është shitur. Ky është dallaveri që bëni ju dhe pastaj vjen këtu dhe tregon çfarë keni bërë. Po çfarë ndodh? A e dini se çfarë ka bërë kryetari i Elisës atje? Ka qenë një shkollë, shkolla "Hillary Clinton", e ndërtuar për banorët e shpërngulur nga Bovilla. Në atë kohë, qeveria "Meksi" e ndërtoi shkollën dhe e shpronësoi tokën. E dini se çfarë bënë qeveria e Elisës me kryetarin e saj? Kanë shpikur një pronar të ri, i cili rezultoi patronazhist, dhe e shpronësojnë për t'i dhënë para. Një tokë e shpronësuar!

Këto janë arritjet që Elisa duhet t'ua thotë banorëve të zonës së saj dhe të zonës sime në Bashkinë e Kamzës, por duhet t'ua thotë edhe shqiptarëve. Kjo është qeverisja! Kjo është forma e qeverisë që aplikojnë! A mund të më thonë se ç' strategji punësimi kanë ndjekur për zonën? Pse po shpopullohet, si asnjë zonë tjetër, bashkia ku ajo është deputete? A mund të më thotë sa banorë dhe sa familje ka ndihmuar? Se është ministre, dhe besoj se një ministre, në princip, është në karrige për t'u shërbyer qytetarëve, së pari, dhe kryesisht atyre të zonës së vet, jo për t'i gënjyer dhe mashtruar. Ka një gjë të vërtetë, që po e përsëris prapë: Elisa dhe "Skënderbeu" jetojnë në botën e tyre të çudirave; shqiptarët jetojnë në botën reale, nuk kanë lidhje me çudirat.

U duket çudi që ka njerëz pa shtëpi, u duket çudi që ka njerëz që flenë në plastmasë, sigurisht, por ky është realiteti, ndaj po jua them dhe po jua përsëris. A e di Elisa, se e kam thënë edhe radhën e kaluar dhe po e përsëris edhe sot, sa është ndihma sociale? 40 mijë lekë të vjetër. A e di Elisa që të gjithë prindërit e nxënësve të shkollave “Hillary Clinton”, “Demokracia”, “Gramos Palushi”, “Azem Hajdari”, “Lidhja e Prizrenit”, “Ibrahim Basha”, “Sulejman Elezi” e të tjera paguajnë 30 mijë lekë në muaj për furgonët dhe mjetet e tjera, në mënyrë private, për t’i çuar dhe për t’i marrë nxënësit nga shkolla? Imagjinoni që këtë pagesë prej 30 mijë lekësh e kanë shpërblim nga deputetja e zonës, ministrja Elisa, nga qeveria e saj dhe nga kryetari i emëruar i komitetit ekzekutiv në Kamëz, Kipe Suli.

Këto janë dhuratat, shpërblimet dhe mrekullitë që ka bërë qeveria e Elisës dhe e “Skënderbeut”. Pastaj vijnë këtu e thonë dokrra e mashtrime. Për ata mjafton të bëjnë sfilata, modë, veshje dhe show, duke folur me një fjalor pak të arrirë. Ndoshta zonjat vijnë këtu edhe për t’i bërë sfidë njëratjetrës se cila foli më bukur apo me fjalë më të mëdha, por realiteti nuk ka të bëjë fare me këto, sepse ne jemi këtu përfaqësues të qytetarëve dhe halleve të qytetarëve. Në qoftë se këta kanë ardhur të jenë showman këtu, atëherë kjo është histori tjetër, por e vërteta është kjo, edhe pse e dhimbshme. Ndaj, turp të keni për pafytyrësinë dhe mashtrimet që u thoni shqiptarëve!